

DATË:	30 Tetor 2024								
AGJENCIA	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL								
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS								
MISIONI I AGJENCISË	<i>Të krijojmë një ambient të aviacionit civil në përputhshmëri me politikat kombëtare dhe standardet ndërkombëtare, përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme, nivelit të lartë të kompetencës profesionale dhe partneritetit me industrinë.</i>								
OBJEKTIVAT	TREGUESI(T)	VLERA BAZË	VLERA E SYNUAR	REZULTATET (OUTPUTET)	AKTIVITETET KRYESORE	ALOKIMI FINANCIAR	AFATI KOHOR	NJËSITË ORGANIZATIVE	REFERENCA NË DOKUMENTE STRATEGJIKE POLITIKE
PLOTËSIMI I KORNIZËS LIGJORE PËR RREGULLIM TË AVIACIONIT CIVIL 2025	Harmonizimi i legjislacionit me aktet normative ndërkombëtare dhe vendore	85%	95%	Qasja në akte nënligjore përmes publikimit në Gazetë zyrtare të RKS	<ol style="list-style-type: none"> <li>Transpozimi i 11 rregulloreve të BE-së në fushën e aviacionit civil</li> <li>Hartimi / Plotësimi i legjislacionit me kërkesat legjislative vendore</li> </ol>	59,490.57	TM1 TM2 TM3 TM4	DSF AGA ZL	Strategjia e transportit multimodal 2023-2030. (Pika 6.4)  PKIE Pika 3.14
NGRITJA DHE MIRËMBAJTJA E NIVELIT TË ZBATIMIT TË STANDARDEVE TË AVIACIONIT 2025	Realizimi i aktiviteteve mbikëqyrëse	85%	95%	Raportet nga Auditimet dhe Inspektimet e realizuara	<ol style="list-style-type: none"> <li>Realizimi i 8 auditimeve dhe, 21 inspektimeve të planifikuara</li> </ol>	224,488.03	TM1 TM2 TM3 TM4	DSF AGA DSHNA DSC DBNRREA	Strategjia e transportit multimodal 2023-2030. (Pika 6.4)
NGRITJA DHE RUAJTJA E KAPACITETEVE NJERËZORE NË AAC 2025	Punësim i stafit në pozita sipas planit të rekrutimit	26 pozita aktuale në AAC	31 pozita të synuara në AAC	Akt emërimet dhe PDP	<ol style="list-style-type: none"> <li>Kërkesat për rekrutim në MPB dhe MFT</li> <li>Realizimi i procesit të rekrutimit</li> </ol>	81,498.69	TM1 TM2 TM3 TM4	ZDP BNJ	Strategjia e transportit multimodal 2023-2030. (Pika 6.4)
	Trajnim i stafit sipas planit për ngritje të kapaciteteve profesionale	69 % i realizuar në vitin 2024.	90%	Kompetenca profesionale e fituar për realizim të detyrave	<ol style="list-style-type: none"> <li>Realizimi i planit të trajnimit</li> </ol>	56,300.00	TM1 TM2 TM3 TM4	Të gjitha Njësitë	

AVANCIMI I ZBATIMIT TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT NË AAC 2025	Përgatitja e sistemit të menaxhimit në AAC për vitin 2025	Jo	Po	Raportet nga auditimet e brendshme dhe të jashtme që dëshmojnë funksionimin e sistemit të menaxhimit	1. Realizimi i planit për përmirësimin dhe avancimin e sistemit të menaxhimit.	176,307.00	TM1 TM2 TM3 TM4	Të gjitha Njësitë	Strategjia e transportit multimodal 2023-2030. (Pika 6.4)
DIGJITALIZIMI	Digjitalizimi i proceseve të punës në AAC si objektivë strategjike për pesë vjeçarin e ardhshëm.	20%	40%	Vlerësimi i gjendjes aktuale;  Përcaktimi i zgjidhjeve për gjendjen aktuale;  Vlerësimi i burimeve indikative (buxheti për vitin 2026)	1. Vlerësimi i infrastrukturës ekzistuese  2. Planifikimi për krijimin e platformës për digjitalizim	17,630.70	TM3 TM4	Të gjitha Njësitë	Strategjia e transportit multimodal 2023-2030. (Pika 6.4)

**Z. Burim Dinarama**  
UD. Drejtor i Përgjithshëm i AAC



**Z. Liburn Aliu**  
Ministër i MMPHI

# SHTOJCË E PLANIT TË PERFORMANCËS PËR AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL TË KOSOVËS PËR VITIN 2025

## PËRSHKRIMI NARRATIV I OBJEKTIVAVE

Këto objektiva janë në përputhje me Strategjinë e transportit multimodal 2023-2030 nga MMPHI, gjegjësisht pika 6.4 Transporti ajror. Objektivat janë në përgjithësi të bazuara në Ligjin për aviacionin civil, i ndryshuar, dhe në veçanti në nenin 15 të Ligjit, ku janë të përshkruara kompetencat dhe përgjegjësitë e AAC-së.

## OBJEKTIVA 1 - HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT ME AKTET NORMATIVE NDËRKOMBËTARE DHE VENDORE

Është objektiv i AAC-së në përmbushje të obligimeve që i kemi bazuar në Ligjin për Aviacionin Civil, nxjerrja dhe transpozimi i rregulloreve të cilat zbatojnë obligimet sipas Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Ajrore Evropiane (ECAA), si dhe nxjerrja e rregulloreve me anë të të cilave bëhet përvetësimi i Standardeve dhe Praktikave të Rekomanduara të nxjerra nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO), me qëllim të zbatimit të politikave të aviacionit civil të MMPHI dhe legjislacionit përkatës nga fusha e aviacionit civil.

### Veprimet:

Gjatë vitit 2025 planifikohen të transponohen këto rregullore të BE-së:

1. Rregullorja e Komisionit (BE) 2024/1030 e datës 27 mars 2024 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 748/2009 në lidhje me përditësimin e listës së operatorëve ajrorë që kryejnë një aktivitet të aviacionit të përfshirë në Aneksin I të Direktivës 2003/87/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.
2. Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2024/1107 e datës 13 mars 2024 që plotëson Rregulloren (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit duke përcaktuar rregulla të detajuara për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore të sistemeve të certifikuar të mjeteve ajrore pa pilot dhe komponenteve të tyre, dhe miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra.
3. Rregullore Zbatuese e Komisionit (BE) 2024/1109 e datës 10 Prill 2024 që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kërkesat e autoriteteve kompetente dhe procedurave administrative për certifikimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin të vlefshmërisë së vazhdueshme ajrore të sistemeve të certifikuar të mjeteve ajrore pa pilot.
4. Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2024/1111 e datës 10 Prill 2024 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 1178/2011, Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 923/2012, Rregulloren (BE) Nr. 965/2012 dhe Rregulloren Zbatuese (BE) 2017/373, që i përket përcaktimit të

kërkesave për operimin e mjeteve ajrore të drejtuara me aftësi vertikale për ngritje dhe aterrim.

5. Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2024/1403 e datës 12 mars 2024 që plotëson Rregulloren (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit duke përcaktuar kushtet dhe procedurat për akreditim nga Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit të subjekteve të kualifikuara.
6. Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2024/1601 e datës 30 maj 2024 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 474/2006 në lidhje me listën e transportuesve ajrorë të ndaluar të operojnë ose që u nënshtrohen kufizimeve operacionale brenda Bashkimit.
7. Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2024/2076 e datës 24 korrik 2024 që ndryshon Rregulloret (BE) Nr. 1178/2011 dhe (BE) Nr. 965/2012 në lidhje me sqarimin e kërkesave për ko-pilotët e ndihmës në fluturim, përditësimet e kërkesave për licensimin e ekuipazhit të fluturimit dhe certifikim mjekësor, dhe përmirësimet për aviacionin e përgjithshëm.
8. Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2022/1645 e datës 14 korrik 2022 që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm mbi sigurinë e aviacionit për organizatat e mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) Nr. 748/2012 dhe (BE) Nr. 139/2014 dhe ndryshimin e Rregulloreve të Komisionit (BE) Nr. 748/2012 dhe (BE) Nr. 139/2014.
9. Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2023/203 mbi Kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit për organizatat dhe autoritetet kompetente.
10. Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2024/405 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 139/2014 në lidhje me përdorimin e sinjaleve në rast të dështimit të radio komunikimit.
11. Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2024/1400 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 139/2014 në lidhje me sigurinë e aerodromeve, ndryshimin e operatorit të aerodromit dhe raportimin e ndodhive.

## **OBJEKTIVA 2 - NGRITJA DHE MIRËMBAJTJA E NIVELIT TË ZBATIMIT TË STANDARDEVE TË AVIACIONIT**

Është objektivë e AAC-së që zbatimi i standardeve të aviacionit, të shprehura në kornizën ligjore të AAC-së të realizohet në nivelin më të lartë të mundshëm. AAC si rregullator i aviacionit civil, në mënyrë të vazhdueshme të bëjë monitorimin e nivelit të zbatimit të këtyre standardeve përmes auditimeve/inspektimeve.

Përmes këtij objektivit AAC në vazhdimësi kontribuon në ngritje të nivelit të zbatimit të standardeve. Përcaktimi i objektivave gjithnjë bëhet në mbështetje të promovimit të sigurisë dhe kulturës së drejtë të operatorët dhe komuniteti i aviacionit civil.

### **Veprimet:**

- 4 auditime të planifikuara në ASHNA;
- 1 auditim i planifikuar në LKIA për shërbimet në tokë për vitin 2025;
- 1 auditim i brendshëm;
- 1 auditim në AeMC;
- 1 auditim në LKIA ATO (DG);
- 15 inspektime SAFA;
- 3 inspektime të planifikuara për aerodrome në LKIA për vitin 2025;
- 1 inspektim i planifikuar për operimet e furnizimit me karburante për mjetet ajrore (ExFis dhe LKIA) për vitin 2025;
- Inspektim në ASHNA sa i përket zbatimit të Vendimit të AAC mbi tarifën terminale të navigacionit 2025;
- Inspektim në LKIA sa i përket realizimit të Programit Nxitës 2022-2025;
- Mbikëqyrja ekonomike vjetore e LKIA për 2024;
- Mbikëqyrja ekonomike vjetore e EXFIS për 2024;
- Mbikëqyrja ekonomike vjetore e ASHNA për vitin 2024 si dhe përcaktimi i tarifës terminale të navigacionit 2026.

### **OBJEKTIVA 3 - NGRITJA DHE RUAJTJA E KAPACITETEVE NJERËZORE NË AAC**

Është objektivë për AAC-në që ngritja dhe ruajtja e kapaciteteve të jenë gjithnjë të kënaqshme, sepse vetëm në këtë mënyrë AAC mund të realizojë detyrat dhe përgjegjësitë që mbanë dhe rrjedhimisht kjo është mënyra e vetme për të garantuar menaxhimin e sigurisë së aviacionit civil në vend. AAC ka nevojë për mbështetje nga institucionet përkatëse që të sigurojnë se institucioni është i mbështetur nga personeli i mjaftueshëm dhe i kualifikuar si dhe i pajisur me burime të mjaftueshme financiare për menaxhimin e sigurisë.

#### **Veprimet:**

1. Hartimi i planit të rekrutimit për pozitat e lira të miratuara
2. Hartimi i planit të trajnimeve të personelit
3. Realizimi i planit të rekrutimit dhe trajnimeve të personelit

## **OBJEKTIVA 4 - AVANCIMI I ZBATIMIT TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT NË AAC**

Është objektivë e AAC-së që të avancojë dhe mirëmbajë sistemin e menaxhimit brenda organizatës. Ky sistem, përveç që është obligativ për AAC-në, është edhe i domosdoshëm për arritje të objektivave përmes përshkrimit dhe zbatimit të përpiktë të proceseve të punës, detyrave dhe përgjegjësive për pozitat e punës, planifikimit, matjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Sistemi i menaxhimit është kërkesë ligjore nga Agjencioni Evropian i Sigurisë së Aviacionit (EASA) përmes një numër Rregulloresh, të transpozuara në rendin e brendshëm juridik, dhe gjithashtu shumë kërkesa për këtë sistem burojnë nga Shtojca 19 nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO) e transpozuar në rendin e brendshëm juridik përmes Rregullores (AAC) Nr. 04/2018 për menaxhimin e sigurisë.

### **Veprim:**

1. Realizimi i planit për Sistemin e Menaxhimit

## **OBJEKTIVA 5 - DIGJITALIZIMI I PROCESVEVE NË AAC**

Është objektivë e AAC-së që në përcjellje të Strategjisë së vendit për transportin multimodal 2023-2030, dhe në synim të avancimit të shërbimeve që ne i ofrojmë, është edhe digjitalizimi i proceseve të punës në AAC. Digjitalizimi është përcaktuar si objektivë strategjike e AAC-së për pesë vjeçarin e ardhshëm. Avancimet teknologjike, duke qenë se janë të domosdoshme për punën dhe gjithnjë sjellin ngritje të efikasiteti në punë, AAC do të përkushtohet që viteve në vijim të gjejë mënyra dhe solucione teknologjike për lehtësimin dhe mbështetjen më të mirë të realizimit të proceseve të punës. E gjithë kjo do të ketë efekt edhe në përmbushje të misionit dhe realizim të objektivave të AAC-së.

### **Veprim:**

1. Vlerësimi i infrastrukturës ekzistuese
2. Planifikimi për krijimin e platformës për digjitalizim

### **Shënim:**

Digjitalizimi i proceseve në AAC është planifikuar të fillojë në pjesën e dytë të vitit 2025, prandaj edhe vlera bazë dhe vlera e synuar janë në përqindje më të vogël për këtë vit. AAC do të planifikoj të rekrutojë një Zyrtar të Teknologjisë Informative (IT) gjatë vitit 2025, që të fillojë me vlerësimin e infrastrukturës ekzistuese. Planifikimi për krijimin e platformës për digjitalizim pritet të vazhdojë viteve në vijim.